

S T A T U T
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot, më 20/11/2023, une ortaku **Z. Stilian Qirici** kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**Smart Industrial Solutions**” sh.p.k
- (2) Themeluesi i shoqërisë është **Z. Stilian Qirici** shtetas shqiptar, i datelindjes 09/11/1997, lindur ne Permet, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr **J711090290**.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin “*Tregti me shumice dhe pakice, import-eksport, montim, mirembajtje, servis, per produkte dhe paisje: Industriale, elektronike, elektrike, hidraulike, hidrosanitare, bujqesore, ndertimi, mobilimi, laborator mjekesor, bujqesor dhe industrial, lavaxterie, kancelarie si dhe produkteve per ujesjellesa, paisjeve kundra zjarrit etj. Mobilim i shkollave, universiteteve, zyrave, porteve, aeroporteve, spitaleve, laboratoreve, burgjeve, hoteleve, sallave te konferencve, teatrove, stadiumeve etj. Tregti me shumice dhe pakice, import-eksport i detergjenteve te pastrimit, tekstileve dhe veshjeve per sigurine ne pune, reagenteve, produkteve ushqimore. Ofrim i siguracioneve te ndryshme TPL, kasko etj. Organizim eventesh. Akomodim ne hotel. Shërbim transporti brenda dhe jashtë vendit. Ndertime te te gjitha tipeve si: civile, ekonomike, industriale, turistike etj. Tregtim materialesh ndertimi, inerte, rere, mermer, etj.. Tregtim automjeteve te te gjitha llojeve, makineri e pjese kembimi per to. Prodhim materiale ndertimi. Ndertim dhe menaxhim i objekteve turistike. Ndertime te te gjitha tipeve rrugore, hidroteknike, rikonstruksione godinash civile etj. Ndertimin e rrjeteve inxhinierike. Projektim, zbatim, ndertim dhe mirembajtje periodike, riparim dhe rehabilitim ne fushen e automatizimit industrial ne makineri, mjete, pajisje, sisteme te ndryshme elektrike, elektronike, mekanike etj. Ndertime, projektme mirembajtje, riparime dhe furnizime te: impianteve te ndryshme, linjave te trajtimit te mbetjeve; sistemimeve, impianteve, linjave te komandimi per HEC-e, centraleve, nenstacioneve TL, TM, TU; sistemimeve, impianteve, linjave ne mjete te renda transporti, paisjeve ulese - ngritese si ashensore, vincave mobile portual dhe civil, vincave elektrike portual dhe civil; sistemeve, impianteve, linjave te automatizimit ne industri, sistemeve, impianteve, linjave, kapanoneve te lidhura me prodhimin; sistemeve, impianteve, linjave te ftohjes dhe te ngrohjes (kondicionimit). Mirembajtje, operim, menaxhim rruge, tylene, ura, mbikalime. Ndertim i tuneleve, urave, mbikalimeve. Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga*”

burime alternative si sistemet fotovoltaike, parqet e erës, termocentralet, biomasa etj. Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave të tyre ndihmëse. Përfshirë dhe pa u kushtëzuar vetëm në marrjen e të gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/përfundimtare, institucionet përgjegjëse shtetërore (qofshin këto organe Qendrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare mbi pasuri të lujtshme apo të palujtshme, që do të vleresohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektivit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitale themeltare të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të afert me të vetin, etj. Shitja me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjisë elektrike (vendas apo të huaj), si dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjisë jashtë vendit. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektin e mësipërm. Për arritjen e qëllimit të mesipërm, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë. Duke përfshirë por pa u kufizuar në ndertimin e linjave elektrike të tensionit të lartë, të mesëm dhe të ulët, nënstacione elektrike dhe njësi të tjera të lidhjeve elektrike, rrugëve të aksesit etj., si dhe çdo aktivitet tjetër i lidhur me sa më sipër, si punime gërmimi, punime për prishjen dhe punime të tjera të tokës, punime civile, elektrike dhe mekanike të çdo lloji. Tregtimin dhe mirembajtjen e pajisjeve të gjithë aktiviteteve të lidhura me këto çështje.”

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në paragrafin 1, të këtij neni mund të shkurtrohet me vendim të Asamblese së Ortakeve të shoqërisë, në përputhje me rregullat për ndryshimin e statutit të përcaktuara nga statuti i shoqërisë.

Neni 4

Selia

Fier, Lushnje, Lagjja Xhevdet Nepravishta, Bulevardi Kongresi, Kompleksi Sol me Nr. Kadastral 8571, Kati I dyte.

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:
stilianqirici@hotmail.com



Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë leke). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e mëposhtme:

- Ortaku themelues z. Stilian Qirici zoterues i një kuote me vlerë 100,000 (Njëqind mijë leke) që perben 100% të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet për kontributet në para dhe për kontributet në natyrë, nepermjet një vendimmarrje bazuar në raportin e një eksperti të autorizuar, për këto kontribute.

Kapitali i regjistruar nuk mund të zmadhohet, nëse nuk janë shlyer ende kontributet për kuotat e nënshkruara më para ose në natyrë.

Administratorët detyrohen të njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për zmadhimin e kapitalit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë tregtare nëse ka një të tillë.

Aplikimi për regjistrimin e vendimit të përmendur me sipër neni shoqërohet me raportin e ekspertit të autorizuar, ku verifikohet vlera e kontributeve në natyrë ose në para.

Pas realizimit të zmadhimit të kapitalit, administratorët i njoftojnë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit realizimin e këtij veprimi. Informacioni shoqëruar duhet të përfshijë listën e personave, që kanë nënshkruar kuotat, së bashku me shumën e paguara. Kjo listë nënshkruhet nga administratorët.

Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Përpara se zmadhimi i kapitalit të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, kuotat nuk mund të transferohen. Kuotat e transferuara në kundërshtim me këtë dispozitë janë të pavlefshme. Personat, që kryejnë shkeljen, përgjigjen ndaj nënshkruarëve në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga një emetim i pavlefshëm.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit sipas nenit 12 të statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë.
- b) shitblerjes.
- c) trashëgimisë.
- ç) dhurimit.
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Ne rastet e kalimit të kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësive mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së cmimit, rregullohen nga kontrata.

Kontrata për kalimin e kuotes hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përben kusht për vlefshmerinë apo regjistrimin e kontrates.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakord në kontrate, vlefshmeria e kalimit të titullit të pronësive mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontrates apo të kalimit të titullit.

Në rastin e shitblerjes së kuotave, sipas rastit asambleja e ortakeve duhet të mbledhet për miratimin e këtij veprimi juridik ose ortaku i cili do të kalojë kuotën duhet të respektojë të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakeve të tjera ekzistues.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i cili ka efekt deklarativ.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- b) ndryshimet e statutit.
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve.
- d) emërimin e shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar.

- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike.
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë.
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “g” dhe “h” të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkates.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet në formë shkresore dhe është i vlefshëm vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

- 1) Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.
- 2) Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 3) Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 4) Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 5) Në rastet e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
- 6) Në rastet e parashikuara në pikat 2 deri në 4 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve



- 7) Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sipas pikës 2, nën 87, të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratoreve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratoreve apo ortakëve.

Neni 10

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat (3/4) e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë.
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve.
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.

- ç) përcaktimin e shpërblimeve.
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 13

E drejta e votes

Cdo kuotë jep të drejtën e një vote.

Nese ortakët, që nuk janë të pranishëm, statuti u jep mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- 1) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale.
- 2) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër.
- 3) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Neni 14

Procesverbalet e Mbledhjes së Shoqërisë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.



Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretë ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 15

Përfshirimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij.
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij.
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria.
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 16

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

- 1) Emerimi i administratoreve, i cili hyn në fuqi në datën e percaktuar sipas aktit të emerimit, u kundrejtohet paleve të treta sipas percaktimeve të nenit 12 të ligjit "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar.
- 2) Vendimi i asamblese për emerimin e administratorit duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 3) Administratorët e një shoqërie tregëtare mëmë, sipas percaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të shoqërisë "**Smart Industrial Solutions**" sh.p.k

- **Z. Stilian Qirici** shtetas shqiptar, i datelindjes 09/11/1997, lindur në Permet, banues në Tiranë, mbajtes i letërnjoftimit nr **J711090290**.

- 4) Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nepërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblese së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të therrë asambletë e përgjithshme për emerimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
- 5) Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emerimin e administratorit të ri në datën e percaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë

administratori i njofton me shkrim doreheqjen Qendres Kombetare te Regjistrimit, se bashku me kopjen e thirrjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme dhe Qendra Kombetare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.

- 6) Doreheqja e administratorit nuk cenon padite e shoqerise per shkelje te detyrimit te besnikerise qe administratori ka ndaj saj, sipas ketij ligji.

Neni 17

Kompetencat e Administratorëve

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryeje të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.
- b) përfaqësoje shoqërinë tregtare.
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.
- ç) përgatise dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim.
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.
- dh) kryeje regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- e) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- ë) kryeje detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërse Asamblene e Përgjithshme, në rastet kur: - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.



Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 18

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet: 1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis:

- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim.
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë.
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori



ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet.
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë.
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë.
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet.
- d) jep kredi.

Neni 19

Shpërndarja e dividendit/fitimit

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj.
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratoret përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese që duhet të leshohet sipas këtij neni.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 20

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 21

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjatë vitit dhe atë në lidhje me

kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja –riorganizimi i shoqërisë
Neni 22
Prishja dhe likuidimi

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohezgjatja, per te cilen eshte themeluar.
 - b) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.
 - c) ne rast se objekti behet i perealizueshem per shkak te mosfunktionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare.
 - d) ne rastet e pavlefshmerise se themelimit te shoqerise, te parashikuara nga neni 3/1 i ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" i ndryshuar.
 - e) ne raste te tjera, te parashikuara ne statut.
 - f) ne raste te tjera, te parashikuara me ligj.
 - g) per cdo shkak tjeter te vendosur nga asambleja e ortakeve.
 - h) me vendim te asamblese te ortakeve per prishjen e shoqerise dhe fillimin e procedurave te likuidimit.
- 1) Prishja e shoqerise, si pasoje e nje apo me shume prej shkaqeve te percaktuara ne shkronjat "a", "c", "d", "f" dhe "g", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga asambleja e ortakeve me shumicen e cilesuar prej tri te katertat e votave $\frac{3}{4}$ te ortakeve pjesemarres., parashikuar sipas pikes 1, te nenit 87, te ketij ligji.
 - 2) Ne rast mosveprimi te asamblese se ortakeve per te vendosur prishjen, per shkaqet e percaktuara ne shkronjat "a", "c", "d", dhe "f", sipas ketij neni, cdo person i interesuar mund, ne cdo kohe, t'i drejtohet gjykates per te konstatuar prishjen e shoqerise.
 - 3) Pavaresisht nga parashikimet e siperpermendura, ekzistenca e nje a me shume shkaqeve, te parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "f" dhe "g", te ketij neni, nuk do te kete si pasoje prishjen e shoqerise dhe hapjen e procedurave te likuidimit, nese perpara vendimit gjyqesor te formes se prere, te permendur ne piken 2, te ketij neni, shkak i prishjes eshte korrigjuar, nese eshte e mundshme te korrigjohet, dhe ky korrigjim eshte publikuar nga shoqeria ne regjistrin tregtar, sipas parashikimeve te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.
 - 4) Prishja e shoqerise, si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "b", te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente per procedurat e falimentimit, kur, ne perfundim te ketyre procedurave, te gjitha pasurite e shoqerise jane likuiduar per

shlyerjen ne menyre kolektive te detyrimeve ndaj kreditoreve apo kur gjykata kompetente per procedurat e falimentimit vendos rrezimin e kerkeses per hapjen e procedures se falimentimit per shkak te pamjaftueshmerise se pasurise se shoqerise per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.

- 5) Prishja e shoqerise si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "c", te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve te nenit 3/1 te ketij ligji."
- 6) Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".
- 7) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 8) Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 23

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare." i ndryshuar.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Ligjit "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU I SHOQERISE

Stilian Qirici

Stilian Qirici